

# STATUTI I THEMELIMIT TE SHOQËRISE ME PERGJËGJËSI TË KUFIZUAR

" ALB - EXCHANGE " Sh.p.k.

*Sot, më datë 21/06/2021, personat e mëposhtëm:*

**1. Z. Klajdi Bektashi**, i biri i Ylli, lindur më 27 / 07 / 1989 në Tirane, banues në Tirane, Rruga Todi Shkurti ,pallati Grand ,i identifikuar permes kartes se identitetit (ID) me Nr. 034074355 dhe Nr.Personal I90727073Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar ;

në perputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” dhe legjisllacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosi të themelojë Shoqërine tregtare të emertuar " ALB - EXCHANGE " Sh.p.k.

## KAPITULLI I

### THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

#### Neni 1

##### Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise është " ALB - EXCHANGE " Sh.p.k.

Shoqeria " ALB - EXCHANGE " Sh.p.k.. eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” (me pas referuar si “ Ligji Tregtar”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar. (SH.P.K).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit (me pas referuar si “QKB”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.



## Neni 2

### Selia

Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën e mëposhtme:

TIRANE, Njësia Administrative Nr. 5, Rruga "Gjik Kuqali", Pallati Nr. 7/1, Apartamenti Nr. 1.

Pasuria Nr.5/223+1-1, Volumi Nr.17, Faqe 163, Zona Kastrale Nr.8270

Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik do të jetë **klajdi.b@hotmail.de** dhe  
Númer Telefoni +355 69 840 7163

## Neni 3

### Objekti

Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar.

Me konkretisht por pa u kufizuar në to, shoqëria ka për objekt:

#### Ushtrim i veprimtarisë në:

- Veprimtaria financiare e kembimeve valutore, shit/blerje valute, shit/blerje ceqe udhëtarësh, transferimi i parave, shërbime financiare, roli i agjentit në ushtrimin e veprimtarisë financiare të transferimit të parave në emer dhe për llogari të një subjekti financiar jo banke.

Shoqëria mundet gjithashtu të ushtrojë çdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti të ligjshëm dhe/ose mund të angazhohet në çdo veprimtari të ligjshme ose aktivitet të lejueshëm nga legjislacioni shqiptar në fuqi për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i cili here pas here mund të ndryshohet në përputhje me dispozitat ligjore të këtij Statuti si dhe të ligjit të zbatueshëm.

Te gjitha këto veprimtari të lartpërmendura duhet të kryhen brenda kufijve dhe sipas dispozitave ligjore që rregullojnë ushtrimin e tyre.

Ortakët e Shoqërisë, deklarojnë dhe garantojnë se gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit tregtar të Shoqërisë, ata nuk do të ndërmarrin, themelojnë, kryejnë apo ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër

private të njëjtë apo të ngjashme me objektin e aktivitetit të Shoqërisë e cila mund t'i shkaktojë konkurrencë Shoqërisë apo mund të dëmtojë interesat e kësaj të fundit.

#### **Neni 4**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar. Shoqëria mund të priset në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në çdo rast me totalin e votave të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.

### **KAPITULLI II**

#### **KAPITALI – KUOTAT**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është i perberë nga kontributët në të holla të ortakëve themelues në vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind) leke . Kapitali themeltar perbehet nga 1

(një) kuote dhe ndahet si më poshtë :

- **Z.Klajdi Bektashi**, zoteron 1 kuote, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind) Leke dhe 2,500,000 (dy milion e pesëqind) leke të kapitalit themeltar.

5.2 Ortaket janë përgjegjës kundrejt paleve të treta për humbjen që pëson Shoqëria, deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

5.3 Kapitali Themeltar mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore.

#### **Neni 6**

#### **Kuotat**

#### **Te drejtat dhe detyrimet e lidhura**



- 6.1 Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote.
- 6.2 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratorit (“Regjistri i Ortakeve”).
- 6.3 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem : ( i ) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku ; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

## **Neni 7**

### **Transferimi i Kuotave**

- 7.1 Kuotat nuk jane lirisht te transferueshme nepermjet trashegimise, por vetem ndermjet Ortakeve apo te treteve, duke ruajtur ortaket te drejten e parablerjes ekzistues.
- 7.2 Kalimi i te drejtave te pronesise, venia peng, barre apo çdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat do te kerkoje ne menyre qe te prodhoje efekt, miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila vendos me shumice absolute.
- 7.3 Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi nje numer kuotash ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me procedure ne vijim.
- 7.4 Nese nje ortak ka per qellim te transferoje te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratorin per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t’u transferoje kuotat dhe kushtet esenciale te transferimit.
- 7.5 Administratori, Brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar – do te informoje me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.6 Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerje, Brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratorit per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratorin nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.

- Administratori Brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftoje me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.7 Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes, ata do te blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.8 Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak sipas nenit 7.6 me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'ia transferoje keto kuota personit/ave te percaktuar.
- 7.9 Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftimin per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuotat objekt transferimi Brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit te percaktuar nga neni 7.6 me siper.
- 7.10 Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshe i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

## **Neni 8**

### **Zmadhimi i kapitalit**

- 8.1 Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji.
- 8.2 Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtojne te drejtat e tyre te parablerjes Brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij proçesi, i ofrohet çdo pale te trete.
- 8.3 Kuotat e reja qe do te shlyhen si me pare ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per ShoqerineTregtare.

## **Neni 9**

### **Zvogelimi i Kapitalit**



- 9.1 Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

### KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE

#### Neni 10

##### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

- 10.1 Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, icili, vec kompetencavete tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
  - b. ndryshime te Statutit;
  - c. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
  - d. miratimi i skemes se shperblimeve per administratorin
  - e. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
  - f. shperndarjen e fitimeve vjetore;
  - g. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
  - h. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
  - i. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
  - j. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
  - k. miratimin e rregullave te zbatueshme proceduriale te mbledhjeve te saj;
  - l. ceshtje te tjera sipas parashikimeve te ketij Statuti.
- 10.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.
- 10.3 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacioni, po ashtu dhe rendi I dites, dhe duhet t'u njoftohet te gjithe Ortakeve jo me pak se 7 (shtate) dite perpara mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per cdo ceshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutut, teksti duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

- 10.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratori dhe kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.
- 10.5 Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë i ndryshem nga Administratori, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.
- 10.6 Ne rastin e vendimeve te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar Ortaket qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë për qind) te kapitalit themeltar. Ne keto raste Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te marre vendime me shumicen absolute te votave te kapitalit pjesemarrës, vec kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar dhe/ose ky Statut. Per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, si ndryshimi I Statutit, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit, shperndarja e fitimit, ristrukturimi dhe prishja e Shoqerise, Asamblese se Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar Ortaket qe zoterojne 100% (njqindpër qind) te kapitalit te regjistruar dhe do te marre vendime me  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave te kapitalit pjesemarrës.

Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk mund te mblidhet per shkak te mungese se kuorunit, Asambleja mblidhet perseri brenda 30 diteve me te njejtin rend dite.

- 10.7 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar/perkates.



10.8 Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratori eshte pergjegjes per mbajtjen e nje kopje te tij.

## Neni 11


### Organi Administrues/Administratori

11.1 Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vite, me te drejte riemerimi.

**Z. Klajdi Bektashi**, i biri i Ylli, lindur më 27 / 07 / 1989 në Tirane, banues në Tirane, Rruga Todi Shkurti ,pallati Grand ,i identifikuar permes kartes se identitetit (ID) me Nr. 034074355 dhe Nr.Personal I90727073Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar ; caktohet administrator i shoqerise me mandat 5 (pese) vjecar, duke filluar me date 21.06.2021 deri me 20/06/2026.

11.2 Administratori/Administratoret do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesoje Shoqerine
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumentave kontabel;
- (iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratimin, se bashku me propozimety per shperndarjene fitimeve;
- (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performance e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;





(ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

#### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE**

##### **Neni 13**

##### **Viti financiar**

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

##### **Neni 14**

##### **Rezerva Ligjore**

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto.

##### **Neni 15**

##### **Dividentet**

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend.

#### **KAPITULLI V**

#### **PRISHJA-LIKUIDIMI**

##### **Neni 16**

### **Prishja e Shoqerise**

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

### **Neni 17**

#### **Likuidimi**

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

### **Neni 18**

#### **Dispozita Perfundimtare**

18.1 Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

18.2 Konfliktet ne lidhje ne kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ku Shoqeria ka seline e saj.

18.3 Me qellim shmangien e çdo paqartësie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

18.4 Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 2 (dy) kopje ne gjuhen shqipe.

### **ORTAKET THEMELUES**

**Z. Klajdi Bektashi**

